



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH.nr 249/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej z. Vedat Poterqoi panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtuar nga operatori ekonomik: "Proglobal" sh.p.k - Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë të aktivitetit të prokurimit: "Furnizim me pajisje zjarrfikëse për nevojat e BZ në Mitrovicë", me nr. të prokurimit: 642-22-5108-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK – Mitrovicë, më datën: 19.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** pajtimi i palëve për ankesën 249/22 të datës 04. 07. 2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje zjarrfikëse për nevojat e BZ në Mitrovicë", me nr. të prokurimit: 642-22-5108-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK – Mitrovicë.
- II. **Obligohet** AK- Komuna e Mitrovicës që aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje zjarrfikëse për nevojat e BZ në Mitrovicë", me nr. të prokurimit: 642-22-5108-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK – Mitrovicë, konform

raportit të ekspertit shqyrtues me të cilin AK është pajtuar të bëjë plotësim ndryshimet në dosjen e tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

- III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.
- V. Me qenë se OE ankues është pajtuar me raportin e ekspertit dhe palët janë pajtuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.
- VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datën 10. 06. 2022, Autoriteti kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë, procedurë e hapur dhe vlera e parashikuar ka qenë 20.000.00 €. OE ka bërë kërkesë për sqarime shtesë me datën 24. 06. 2022, ndërsa AK i është përgjigjur me datën 29. 06. 2022. OE ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datën 29. 06. 2022.

Kundër vendimit të AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim konform nenit 108/A të LPP-së, operatori ekonomik ankues “Progobal”, me datën: 04.07.2022, ka parashtruar ankesë me nr:

249/22, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me pajisje zjarrfikëse për nevojat e BZ në Mitrovicë”, me nr. të prokurimit: 642-22-5108-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK – Mitrovicë.

OE ankues në ankesë pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, siç janë:

Neni 1 - Qëllimi

Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 28 - Specifikimet teknike

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 21. 07. 2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 15.07.2022, në raportin e ekspertizës ka deklaruar:

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “**Proglobal**” sh.p.k - Prishtinë të aprovohet si e bazuara, dhe rekomandon që të bëhen plotësim/ndryshimet e nevojshme dhe të zgjatet afati për ofertim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 15 korrik 2022 me raportin e ekspertizës.

1. Autoriteti kontraktues Komuna e Mitrovicës së Jugut me datën 20 korrik 2022 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së dhe nuk kanë asnjë kundërshtim.
2. Operatori ekonomik ankues “Proglobal” m datën 20 korrik 2022 ka njoftuar OSHP-në

se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, deklarimeve të palëve se pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues për plotësim ndryshim të dosjes së tenderit dhe zgjatje të afatit për ofertim, paneli shqyrtues deklaron se procedura e shqyrtimit të ankesës përfundon në këtë fazë, ndërkaq obligohet Autoriteti Kontraktues Komuna e Mitrovicës së Jugut që të zgjasë afatin për ofertim dhe të bëjë plotësim ndryshimet në dosje të tenderit sipas mendimit të ekspertit shqyrtues dhe brenda afatit 10 ditor konform LPP-së ta njoftoj panelin shqyrtues me veprimet e ndërmarra.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Komuna e Mitrovicës
- 1x1 OE "Progobal"
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së